REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE
Njësia org. / Org Jedinica / Org Unit: 51-02
Nr. i Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: 3917-2/20
Nr. i Faqeve / Br. Stranica / No.Pages: -04-
Data / Datum / Date: 13.02.24
PRISHTINË / A No. 1

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria – Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara /Office of the General Secretary*

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 17.11.2023 |
| REFERENC-Ë: | 20/3917/MMPHI |
| PËR/ZA/TO: | "MATKOS GROUP HC VIÇA" L.L.C. Prishtinë Hidrocentrali "VIÇA" në Drekocë- Shtërpcë |
| CC: | Komisioni për Leje Mjedisore |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | |
| NGA/OD/FROM: | Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Vendim për Leje Mjedisore |

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "MATKOS GROUP HC VIÇA" L.L.C. Prishtinë, me Nr. Prot. 20/3917/MMPHI.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni :

1. Vendimi për Leje Mjedisore për operatorin "MATKOS GROUP HC VIÇA" L.L.C. Prishtinë, për hidrocentralin "VIÇA" në Drekocë- Shtërpcë; dhe
2. Shtojcën: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Me respekt!


Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307; https://mmphi.rks-gov.net/

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria – Vlada - Government***

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara /Office of the General Secretary*

Nr.: 20/3917/MMPHI
Datë: 17.11.2023

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Vendimit për Pëlqim Mjedisor me Ndryshim- Vendimi për Pëlqim Mjedisor nga vendimi me Nr. 13/1016/3-ZSP-243/13, i lëshuar me dt. 09.12.2013 ipet ndryshim vendimi me Nr. 14/3721/1-ZSP/182/14, te lëshuar me dt. 09.09.2014, si dhe Mendimit Profesional të Komisionit për Leje Mjedisore te dt. 14.11.2023, nxjerr këtë:

# VENDIM

1. Operatorit "MATKOS GROUP HC VIÇA" L.L.C. Prishtinë, pajiset me Leje Mjedisore për hidrocentralin "VIÇA" në Drekocë- Shtërpcë në ngastrën kadastrale nr. 01373-0, zona kadastrale Drekocë- Shtërpcë, sipas Lejes Ndërtimore me nr. prot. 351-2425, te lëshuar me dt. 17.04.2014 nga e Komuna e Shtërpcës.

2. Operatori obligohet:

2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;



Adresa: Objekti i Qeverisë, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307; https://mmphi.rks-gov.net/

2.2. Të respektohet prurja e pranueshme ekologjike në përputhje me Lejet Ujore për shfrytëzim të ujit, konform Ligjit te ujërave dhe akteve nen ligjore që derivojnë nga ky Ligj;

2.3. Nuk lejohet marrja e sasisë se ujit si prurje minimale biologjike ne këto raste duhet te ndërpritet puna dhe funksionimi i Hidrocentralit;

2.4. Te përcaktohet prurja e pranueshme ekologjike e ujit ne shtratin e lumit;

2.5. Te realizohet monitorimi i vazhdueshëm i niveleve dhe prurjeve te ujit mbi dhe poshtë profilit ujë-marres, me te cilat regjistrohet prurja natyrore deri ne objektin ujë-marres, dhe prurja e pranueshme ekologjike poshtë profilit ujë-marres. Matjet duhet te kryhen me pajise automatike online;

2.6. Pajisjet matëse Hidrologjike duhet te vendosen me aprovimin e IHMK-së;

2.7. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike, që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, po ashtu në rast të ndonjë aksidenti mjedisore të njoftoj MMPHI-në;

2.8. Nëse ne zonën e operimit te "HC VICA" parashihet apo planifikohet projekt nacional nga Qeveria e Republikës se Kosovës për nevojat me furnizim me ujë te pijes apo edhe për ujitje ne bujqësi, operatori është i obliguar qe brenda 24 muajve para se te filloj projekti nacional për implementim te i largoje te gjitha pajisjet Hidroenergjetike pa te drejte kompensimi.

2.9. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit mjedisor që është përgjegjës për mjedis;

2.10. Pas përfundimit të veprimtarisë, operatori është i obliguar të ri kultivimin dhe rehabilitimin e zonës operuese.

Afati i lejes Mjedisore është për periudhën 5 (pesë) vjeçare nga dita e lëshimit te këtij vendimi.

## Arsyetim

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin "MATKOS GROUP HC VIÇA" L.L.C. Prishtinë, është konstatuar se Operatori për hidrocentralin "VIÇA" në Drekocë- Shtërpcë në ngastrën kadastrale nr. 01373-0, zona kadastrale Drekocë-Shtërpcë, sipas Lejes Ndërtimore me nr. prot. 351-2425, te lëshuar me dt. 17.04.2014 nga e Komuna e Shtërpcës, plotëson kriteret minimale te parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet minimale administrative dhe mjedisore ku merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Afati i përcaktuar i lejes mjedisore ne dispozitiv është përcaktuar, komfor nenit 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.



Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, Ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307; https://mmphi.rks-gov.net/

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Këshilla Juridike**: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

__________________________

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i 'dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Shtërpcë-së;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komisionit për Leje Mjedisore;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së



Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38 200-32-307; https://mmphi.rks-gov.net/

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*
*Ministry of Enviroment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Departamenti për Mbrojtjes e Mjedisit dhe Ujërave / Departament za Zaštitu Sredine i Voda / Department of Environment Protection and Waters*

| | |
|---|---|
| REFERENC-Ë: | 20/3917/450/MMPHI-DMMU |
| DATË/A: | 17.11.2023 |
| PËR/ZA/TO: | Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI |
| CC: | Tafë Veselaj, U.D. i Drejtorit të DMMU<br>Visare Istrefi, U.D. Udhëheqëse e DMNI-së |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | |
| NGA/OD/FROM: | Shpend Agaj, kryesues i komisionit për Leje Mjedisore |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Përgjigje lidhur me Leje Mjedisore për operatorin "MATKOS GROUP HC VIÇA" L.L.C. Prishtinë Hidrocentrali "VIÇA" në Drekocë- Shtërpcë |

Te nderuar,

Bashkëlidhur gjeni lëndën me nr. Protokolli: 20/3917/450/MMPHI-DMMU, të operatorit "MATKOS GROUP HC VIÇA" L.L.C. Prishtinë, për hidrocentralin "VIÇA" në Drekocë- Shtërpcë.

Me respekt,

## LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

| | |
|---|---|
| **REFERENC-Ë:** | 20/3917/450/ MMPHI-DMMU |
| **PËR/ZA/TO:** | Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI |
| **CC:** | Ismail Hetemaj, Zëvendësues i Drejtorit të DMMU<br><br>Visare Istrefi, U.D. Udhëheqëse e DMNI-së |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | |
| **NGA/OD/FROM:** | Komisioni për Leje Mjedisore |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Përgjigje ne kërkesën e operatorit "MATKOS GROUP HC VIÇA" L.L.C. Prishtinë Hidrocentrali "VIÇA" në Drekocë- Shtërpcë |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Nr. i zyrës:**<br>**Br. kancelarije:**<br>**Room No.:** | 1517 | **Lokacioni:**<br>**Kucni:**<br>**Extension:** | Ish pallati i mediave Rilindja, Prishtinë. | **Data:**<br>**Datum:**<br>**Date:** | 17.11.<br>2023 |

| | |
|---|---|
| PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION | ☐ |
| PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL | ☒ |
| PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE | ☒ |
| PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS | ☐ |
| A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY ËE DISCUSS | ☐ |
| VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION | ☐ |
| SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED | ☒ |
| SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED | ☒ |
| SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN | ☒ |
| PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION | ☐ |
| **AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE** | |

I nderuari Sekretar,

Komisionit për Leje Mjedisore i emëruar me Vendimin Nr. 3957/23, me nr. prot. 3957-2/2023, të dt. 25.07.2023, duke u bazuar në nenin 31 të Ligjit Nr. 03/L- 025 për Mbrojtjen e Mjedisit si dhe neni 8 i Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, në afatin e paraparë ligjorë, jep këtë Mendim Profesional:

Operatori "MATKOS GROUP HC VIÇA" L.L.C. Prishtinë, ka aplikuar me Nr. Prot. 20/3917/450/MMPHI-DMMU për tu pajisur me Leje Mjedisore për hidrocentralin "VIÇA" në Drekocë- Shtërpcë në ngastrën kadastrale nr. 01373-0, zona kadastrale Drekocë- Shtërpcë, sipas Lejes Ndërtimore me nr. prot. 351-2425, te lëshuar me dt. 17.04.2014 nga e Komuna e Shtërpcës.

Kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisore i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 56, datë 19.11.2015, për përcaktimin e kritereve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrit të biznesit me Nr. 71284778;
- Komuna e Shtërpcës- Vendim për dhënien e pronës komunale ne shfrytëzim afatshkurtër pa procedurë te konkurrimit për ndërtimin e Hidrocentraleve te vogla ne Komunën e Shtërpcës me nr. prot. 01-16-1623, te lëshuar me dt. 03.06.2013;
- Komuna e Shtërpcës- Vendim preliminar mbi lejimin e krijimit te servitutit sendor me nr. prot. 02/16-992, te lëshuar me dt. 11.01.2013;
- Komuna e Shtërpcës/Drejtoria për Planifikim, Rindërtim, Urbanizëm dhe Mbrojtje te Mjedisit Jetësor- lëshon Pëlqim me nr. prot. 06.16-851, te lëshuar me dt. 29.03.2013;
- Komuna e Shtërpcës/Drejtoria për Planifikim, Rindërtim, Urbanizëm dhe Mbrojtje te Mjedisit Jetësor- lëshon Pëlqim me nr. prot. 02-06-352-1125, te lëshuar me dt. 14.05.2013;
- Komuna e Shtërpcës/Drejtoria për Planifikim, Rindërtim, Urbanizëm dhe Mbrojtje te Ambientit- lëshon Leje Ndërtimore me nr. prot. 351-2425, te lëshuar me dt. 17.04.2014;
- Komuna e Shtërpcës/Drejtoria për Planifikim, Rindërtim, Urbanizëm dhe Mbrojtje te Ambientit- ka lëshuar Certifikatë te Përdorimit me nr. prot. 06-351/02-3340/20, te lëshuar me dt. 11.03.2020;
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinore- Ndryshim- Vendimi për Pëlqim Mjedisor nga vendimi me Nr. 13/1016/3-ZSP-243/13, i lëshuar me dt. 09.12.2013

duke zëvendësuar kapacitetin prej 2.5MW ne 4.8MW, ipet ndryshim vendimi me Nr. 14/3721/1-ZSP/182/14, te lëshuar me dt. 09.09.2014;

- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinore- Ndryshim Vendimi - Pëlqimit Ujor nga Vendimi me Nr. 732-3/14-ZSP-482, te datës 02.05.2014, ne Ndryshim Vendimin me Nr. 3449-2/14-ZSP-1178, te lëshuar me dt. 28.10.2014;
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinore- Ndryshim Vendimi - Pëlqimit Ujor nga Vendimi me Nr. 3449-2/14-ZSP-1178, te datës 28.10.2014, ne Ndryshim Vendimin me Nr. 732-3/15-ZSP-335, te lëshuar me dt. 07.03.2016;
- Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit- Vendim për Leje Ujore me Nr. 732-4/16-ZSP-2021, te lëshuar me dt. 09.02.2021;
- KEDS- Pëlqim Elekroenergjetik me nr. prot. 6834, te lëshuar me dt. 18.06.2014;
- Zyra e Rregullatorit për Energji- Vendim me Kodin e ZRRE-së: V_1077_2018, te lëshuar me dr. 20.12.20218;
- KEDS- Raport Teknik me nr. prot. 7399, te lëshuar me dt. 18.09.2020.

Komisioni për Leje Mjedisore ka realizuar dy vizita ne terren te operatori, për verifikimin e kushteve mjedisore me dt. 02.03.2021 dhe me dt. 14.09.20122.

Komisioni, pas realizimit te vizitës se pare në teren ka kërkuar nga operatori, plotësim kushteve mjedisore te cekura me poshtë:

- Rehabilitimin dhe ri kultivimin e zonës ku është ndërtuar objekti i Hidrocentralit;
- Rehabilitimin dhe ri kultivimin e zonës ku ka shtrirje te trasesë;
- Rehabilitimin dhe ri kultivimin e zonës te veprave marrëse.

Ne vizitën e dyte është vërtetuar plotësimin e kërkesave lidhur me rehabilitimin dhe ri kultivimin e terrenit.

Komisioni, pas shqyrtimit të kërkesës te operatorit në fjalë duke përfshirë aplikacionin, dokumentacionin përcjellës qe nevojitet për pajisje me leje mjedisore dhe gjendjes faktike në teren, në takimin e mbajtur me dt. 14.11.2023, në përbërje prej katër (4) anëtareve, unanimisht, kanë dhen mendim profesional si ne vijim:

Operatori i ka sjellë të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Udhëzimin Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, gjithashtu operatori i ka plotësuar të gjitha kushtet administrative dhe mjedisore, dhe si përfundim Komisioni rekomandon që ti lëshohet Leja Mjedisore.

Bashkangjitur këtij Mendimi Profesional gjeni edhe propozim vendimin për Leje Mjedisore.

Komisioni:

Shpend Agaj, kryesues ____________
Adem Tusha, anëtar ____________
Përparim Terziu, anëtar ____________
Fatmir Bytyqi, anëtar ____________
Ilir Kryeziu, anëtar *Nuk ka qene prezent ne takim*